

**Përkufizimi i Termave të Përzgjedhur Financiarë, raporteve,
dhe Axhustimeve në Mikrofinancë**

Mirënjohje

Ky projekt u iniciua nga Damian von Stauffenberg i MicroRate. Kontribuesit pwrfshejnw Frank Abate i MicroRate, Tillman Bruett i Alternative Credit Technologies dhe Rrjeti SEEP, Isabelle Barres e MicroBanking Bulletin, Robert Christen dhe Richard Rosenberg tw Consultative Group to Assist the Poorest (CGAP), Dana de Kanter e SEEP Network, Tor Jansson i InterAmerican De

PERMBAJTJA

Hyrje 2

I. Termat Financiare.....	3
<i>Pasqyra e të Ardhurave.....</i>	<i>3</i>
<i>Bilanci.....</i>	<i>3</i>
<i>Terma shesë.....</i>	<i>3</i>
II. Raportet Financiare 3	
<i>Cështje të llogaritjeve.....</i>	<i>3</i>
<i>Vjetorizimi.....</i>	<i>3</i>
<i>Mesataret.....</i>	<i>3</i>
<i>Qëndrueshmëria/Përfitueshmëria.....</i>	<i>3</i>
<i>Menaxhimi i Aseteve /Detyrimeve.....</i>	<i>3</i>
<i>Cilësia e portofolit.....</i>	<i>3</i>
<i>Eficienta/Produktiviteti.....</i>	<i>3</i>
III. Axhustimet.....	3
<i>Axhustimi i subvencioneve.....</i>	<i>3</i>
<i>Axhustimi i Inflacionit.....</i>	<i>3</i>
<i>Axhustimi për kreditë jo qarkulluese.....</i>	<i>3</i>
<i>Axhustimi për kursin e këmbimit.....</i>	<i>3</i>
<i>Tabelë: axhustimet e pasqurave Financiare dhe efekti i tyre.....</i>	<i>3</i>

Hyrje

Evolucioni i industrisë së mikrofinancës ka cuar në një fokusim më të gjerë të rendimentit të institucioneve të mikrofinancës (IMF). Janë përdorur një sërë masash për të matur ecurinë e IMF, shumë prej të cilave njihen si tregues standartë. Në një ekzaminim më të thellë, është evidente se këto tregues standartë llogariten dhe zbatohen në mënyra të ndryshme. Kjo ka krijuar konfuzion midis praktikuesve dhe analistëve, si dhe deformime të konsiderueshme në krahasimin e IMF. Industria e njeh këtë mangësi dhe bie dakort se përcaktimi i përkufizimeve standarte të termave financiare dhe të disa treguesve të përbashkët është një hap i rëndësishëm i mëtejshëm në zhvillimin e tij. Ky hap do ta bëjë krahasimin midis IMF më me kuptim dhe do të nxisë transparencën në raportimin e IMF. Transparenca është gjithnjë e më e rëndësishme në këtë industri, pasi IMF e zhvilluara tashmë kërkojnë burime komerciale financimi dhe investitorë për të mbështetur zhvillimin e tyre. Pritet që kjo letër të jetë një hap përpara në krijimin e një terminologjie standarte për disa terma dhe raporte financiare brenda industrisë ndërkombëtare të mikrofinancës.

Termet dhe raportet e prezantuar këtu përfshijnë kryesisht ato që autori beson se jo vetëm përdoren gjerësisht, por gjithashtu janë edhe objekt konfuzioni. Ky dokument i drejtohet një audience që janë familiarizuar me termat kontabël, pasqyrat financiare, dhe institucionet e mikrofinancës. Objektivi kryesor i këtij dokumenti është të japë përkufizimet standarte për termat e përzgjedhur financiare, dhe të sugjerojë një metodë standarte për llogaritjen e raporteve të caktuara financiare. Dokumenti është ndarë në tre seksione që përfshijnë (I) një listë të termave financiare dhe përkufizimeve, (II) një përshkrim të raporteve financiare dhe (III) një diskutim dhe përshkrim të axhustimeve financiare.

Kontribuesit e kësaj përpjekjeje pohojnë se nuk është e mundur që të gjithë institucionet e mikrofinancës të përdorin të njëjtat standarte kontabël dhe të njëjtat plane llogarish, të cilat shpesh diktohen nga praktikat lokale dhe nevojat e brendëshme. Për të qenë të qartë duhet theksuar se ky dokument nuk duhet përdorur si zëvendësues për planin e llogarive apo politikat e kontabilitetit. Gjithashtu ky dokument nuk ka si qëllim të trajtohet si një udhëzues për analizat financiare, pasi analistët mund të përdorin tregues të tjerë financiarë dhe dokumente të ndryshme nga ato që përmban ky dokument. Ka shumë materiale të cilave mund t'i referohen IMF apo analistët, disa prej të cilave janë listuar në fund të këtij dokumenti.

Qëllimi i këtij dokumenti është të krijojë përkufizime standarte për disa terma dhe raporte që përdoren gjerësisht. IMF mund t'i referohen këtij dokumenti kur i raportojnë burimeve të jashtëme për të treguar nëse raportet e IMF ndjekin standartet e këtij dokumenti. Nëse një IMF nuk dëshiron të përdorë përkufizimet e dokumentit apo formulat e sugjeruara këtu, mund ta përdorë dokumentin si pikë reference për të shpjeguar se si përkufizimi apo formula ndryshon nga standarti. Në vitet e ardhshëm, Rrjeti SEEP ka si objektiv të hartojë një guidë më të kuptueshme për termat financiare, raportet dhe axhustimet që do t'i udhëheqin menaxherët e IMF në kategorizimin e llogarive dhe përlllogaritjen e raporteve kyc si dhe të axhustimeve.

I. Termat Financiare

Ky seksion përkufizon llogaritë financiare kyc të përdorura nga IMF. Përkufizimet paraqiten në dy seksione kryesore, (1) ato që gjenden në paqyrën e të ardhurave; dhe (2) ato që gjenden në bilanc. Ka edhe disa përkufizime shtesë që do të ndihmojnë lexuesit për të kuptuar formulat e raporteve financiare. Shumica do të prezantohen në të njëjtën rradhë sic paraqiten në pasqyrat financiare.

Pasqyra e të ardhurave

Pasqyra e të ardhurave njihet gjithashtu edhe me emrin pasqyra fitim humbje. Ajo është një pasqyrë që përmbledh të gjithë aktivitetin financiar gjatë një periudhe të caktuar, zakonisht një muaj, tremujor apo vit. Ajo paraqet gjithë të ardhurat dhe shpenzimet për një periudhë të caktuar. Qëllimi kryesor i një pasqyre të të ardhurave është paraqitja e të ardhurave neto (ose fitimi apo teprica neto) për periudhën.

Termat “revenue” dhe “income” përdoren zakonisht për njëra tjetrën ashtu si dhe termat “income” dhe “profit”. Për hir të uniformitetit, ky dokument i referohet fitimit bruto si “revenue”, si psh të ardhurat nga interesi apo komisionet. Gjithë të ardhurave neto i referohemi si të ardhura “income”, si psh të ardhura operacionale neto. IMF, të cilat zgjedhin të përdorin termat të ardhura nga interesi dhe komisionet dhe fitim neto operacional, janë të lirë t’i përdorin në këtë mënyrë, por duhet të dinë se këto llogari përcaktohen nën emra të ndryshëm në këtë dokument. Një asterisk (*) përdoret për të treguar ato terma të cilave mund t’i referohemi si të ardhura.

- I1 **Të ardhurat financiare (revenue) nga portofoli i kredisë** – të ardhurat nga interesi i grumbulluar dhe komisionet (përfshirë komisionet e vonuara dhe gjobat) vetëm mbi portofolin bruto të kredisë. Kjo kategori nuk përfshin vetëm interesin e paguar në kesh, por edhe atë të përlllogaritur, por ende të papaguar.
- I2 **Të ardhurat* financiare (revenue) nga investimet** – të ardhurat nga interesi, dividendët apo pagesat e tjera të gjeneruara nga asetet financiare, vec portofolit bruto të kredisë, si depozitat me interes, certifikatat e depozitave, dhe obligacionet e thesarit. Kjo kategori nuk përfshin vetëm interesin e paguar në kesh, por edhe atë të përlllogaritur, por ende të papaguar.
- I3 **E ardhura * financiare (revenue) (Totale)** – përfshin I1 dhe I2, të ardhura të gjeneruara nga të dyja, nga portofoli bruto i kredisë dhe investimet.
- I4 **Shpenzim interesi dhe komisione mbi detyrimet e financimit** – i gjithë interesi, dhe komisionet e llogarive të depozitave të klientëve mbajtur nga IMF, si dhe huazimet tregtare apo koncesionare nga IMF që përdoren për të financuar gjithë asetet financiare. Në përgjithësi, kjo nuk përfshin shpenzimin e interesit mbi

detyrimet që financojnë asetet fikse (B14), si hipoteka apo interesi i qerasë. Ajo përfshin interesin e përlogaritur si dhe atë të paguar në kesh.

I5 **Shpenzimet financiare** – gjithë interesi, taksat dhe komisionet e kryera për gjithë detyrimet (B14), përfshirë llogaritë e depozitave të klientëve të mbajtura nga IMF (B11) huazimet tregtare apo koncesionale (B12, B13), hipotekat, dhe detyrimet e tjera. Ajo mund të përfshijë gjithashtu komisionet lehtësuese për linja kredie. Ajo përfshin interesin e përlogaritur si dhe atë të paguar në kesh.

I6 **Shpenzimi për provigjionet për humbjet e kredisë** – një shpenzim jo-kesh që përdoret për të krijuar apo për të rritur rezervat për humbjet e kredisë (B5) në bilanc. Shpenzimi llogaritet si një përqindje e vlerës së portofolit bruto të kredisë që është në risk apo i papaguar. Është shumë e zakonshme të përdoret termi provigjon për humbjet e kredisë në vend të termit rezervë për humbjet e kredisë apo anasjelltas.

Për të shmangur konfuzionin midis këtij shpenzimi dhe rezervës për humbjet e kredisë, analistët preferojnë të përdorin termin *rezervë* për llogarinë e bilancit, dhe termin *provigjon* vetëm për llogarinë e shpenzimit. Është gjithashtu më e lehtë të përdorësh termin *shpenzim* kur i referohemi kësaj llogarie.

I7 **E ardhura operacionale (revenue) (Totale)** – përfshin gjithë të ardhurën financiare (I3) si dhe të ardhurat e tjera operacionale. Një e ardhur tjetër operacionale është ajo që gjenerohet nga shërbimet e tjera financiare, si psh taksat dhe komisionet për shërbimet financiare që nuk kanë të bëjnë me kredinë, të cilat nuk konsiderohen si të ardhura financiare. Kjo kategori mund të përfshijë të ardhurat që lidhen me huadhënien si psh kuotat e anëtarësimit, kuotat për kartat ATM, komisionet e transferimit apo shërbime të tjera financiare si shërbimi i pagesave apo siguracionet. Të ardhurat operacionale mund të përfshijnë të ardhurat/(humbjet) neto nga kursi i këmbimit të monedhës së huaj. (Shih Seksionin III për më tepër informacion lidhur me regjistrimin e këtij shpenzimi).

Të ardhurat operacionale nuk përfshijnë të ardhurat që nuk janë gjeneruar nga biznesi kryesor i IMF që është bërja e kredive dhe sigurimi i shërbimeve financiare si shitjet **such as merchandise sales** (shih I12). Megjithatë, nëse IMF e konsideron trajnimin si një element integral të shërbimit financiar që ajo ofron, atëherë e ardhura nga trajnimi do të përfshihet në Të Ardhurat Operacionale.

- I8 **Shpenzimet e personelit** – përfshijnë pagat e stafit, shpërblimet, si dhe taksat e punësimit që paguhen nga IMF. Kësaj kategorie mund ti referohemi edhe si *paga dhe shpërblime* apo *shpenzime stafi*. Ajo mund të përfshijë gjithashtu dhe/ose kostot e rekrutimit dhe të orientimit fillestar. Ajo nuk përfshin trainimin e vazhdueshëm apo të specializuar për punonjësit ekzistues, i cili është një shpenzim administrativ.
- I9 **Shpenzimet administrative** – shpenzimet jo-financiare që lidhen direkt me sigurimin e shërbimeve financiare apo shërbimeve të tjera që formojnë një pjesë integrale të marrëdhënieve të shërbimit financiar me klientët e tij. Shembujt përfshijnë amortizimin, qeranë, pajisjet, kancelaritë, reklamën, transportin, komunikimin dhe komisionet për konsulencën. Kjo kategori nuk përfshin taksat për punësimin, të ardhurat apo fitimet, por mund të përfshijë taksat për tranzaksionet dhe blerjet, si psh taksa mbi vlerën e shtuar.
- I10 **Shpenzimet operative (Totale)** – përfshin gjithë shpenzimet për personelin (I8) dhe shpenzimet administrative (I9), por përjashton gjithë shpenzimet financiare (I5) dhe shpenzimet për provigjonet për humbjet e kredisë (I6). Nuk përfshin shpenzimet lidhur me shërbimet jo-financiare (shih I13). Autorët mendojnë se është e zakonshme t'i referohemi shumës së të gjithë shpenzimeve nga operacionet (dmth shpenzimet financiare dhe ato për provigjonet për humbjet e kredisë) në përkufizimin e këtij termi, vetëm si të ardhura operationale nga veprimtaria. **Megjithatë, përkufizimi i propozuar këtu korrespondon me përdorimin më të zakonshëm në banka.**
- I11 **Të ardhura operationale neto** – të ardhurat totale operationale (I7) minus gjithë shpenzimet që lidhen me veprimtarinë bazë të IMF që është shërbimi financiar, përfshirë shpenzimet totale operationale (I10), shpenzimet financiare (I5), shpenzimet për provigjonet mbi humbjet e kredisë (I6). Kjo nuk përfshin donacionet, shpenzimet për të ardhurat nga shërbimet jo-financiare. – ose taksat mbi të ardhurat apo fitimet – Kjo është problematike. Shiko shënimin në R1.
- I12 **Të ardhura jo-operationale *** – gjithë të ardhurat jo të lidhura drejtpërdrejt me veprimet themelore të mikrofinancës, si të ardhurat nga shërbimet e zhvillimit të biznesit, trajnimi, **or sale of merchandise**. Donacionet dhe të ardhurat nga grantet mund të konsiderohen gjithashtu si të ardhura jo – operationale, por rekomandohet që të përfshihen në llogarinë e tyre. Rekomandohet me forcë që IMF me të ardhura apo shpenzime jo-operationale të rëndësishme duhet të prodhojnë një pasqyrë të ardhurash të segmentuar, të organizuar për të treguar të ardhurat neto operationale (I11), të ardhurat neto jo-operationale (I12-I13), dhe të ardhurat neto të konsoliduara. Të paktën, IMF duhet të shkruajë një shënim për të detajuar të ardhurat jo-operationale nëse ato janë të rëndësishme.

- I13 **Shpenzime jo-operacionale** – të gjitha shpenzimet që nuk janë të lidhura drejtpërdrejtë me veprimet themelore të mikrofinancës, si kostoja e sigurimit të shërbimeve të zhvillimit të biznesit apo trajnimit (nëse IMF nuk e përfshin trajnimin si kërkesë për marrjen e një kredie).
Kjo kategori mund të përfshijë shpenzimet e jashtëzakonshme të cilat janë shpenzime që bëhen vetëm një herë nga IMF dhe nuk mendohet që do të përsëriten në vitet e ardhshme. Kur IMF të kenë programe të rëndësishme jo-financiare, është shumë e zakonshme përdorimi i raporteve të segmentuara nëse është e mundur ose, të paktën, të shkruhet një shënim ku të detajohen shpenzimet jo-operacionale nëse ato janë të rëndësishme.
- I14 **Taksat** – përfshin gjithë taksat paguar për të ardhurat neto apo fitime të tjera sic përcaktohen nga autoritetet lokale të taksave. Kjo kategori mund të përfshijë cdo taksë mbi të ardhurat. Ajo përjashton taksat që lidhen me punësimin e personelit, tranzaksionet financiare, blerjen e aseteve fikse, apo taksat e tjera mbi vlerën e shtuar (që duhet të përfshihen në shpenzimet operacionale)
- I15 **Të ardhurat neto** – të ardhurat totale minus shpenzimet totale operacionale dhe jo - operacionale, përfshirë gjithë donacionet dhe taksat, nëse ka. Disa nga IMF preferojnë të prezantojnë të ardhurat neto përpara donacioneve dhe taksave. Nëse është kështu, IMF duhet ta shënojnë atë si të tillë.

Bilanci

Bilanci është është një fotografi e castit e IMF në një moment të caktuar. Kjo pasqyrë reflekton së çfarë zotëron IMF dhe çfarë i detyrohen asaj (asete), çfarë i detyrohet ajo të tjereve (detyrimet), dhe diferenca midis të dyjave (kapital apo asete neto). Bilanci tregon pasurinë neto të një institucioni në një moment të caktuar

Kur i referohemi llogarive të bilancit, termi *afat-shkurtër* i referohet cdo llogarie apo pjese të llogarisë që maturohet brenda 12 muajsh. Portofoli i kredise *afat – gjatë* është një llogari apo pjesë llogarie që maturohet pas 12 muajsh.

- B1 **Portofoli bruto i kredisë** – bilanci i principalit outstanding të të gjitha kredive outstanding të IMF përfshirë kreditë në afat, të pashlyera dhe ato të ristrukturuara, por jo kreditë të cilat janë fshirë nga bilanci. Ai nuk përfshin interesin për t'u arkëtuar. Megjithëse disa IMF mund t'i kërkohej të përfshijnë bilancin e interesit të përllogaritur dhe për t'u arkëtuar, IMF duhet të vërë një shënim ku të jepet një ndarje midis shumës së gjithë pagesave të principalit outstanding dhe shumës së gjithë interesit të përllogaritur. Disa IMF zgjedhin të break doën komponentët e portofolit bruto të kredisë (shiko B2, B3, B4).

Portofolit bruto të kredisë shpesh i referohemi si *portofol kredie* apo *kredi outstanding*, përcaktime të cilat krijojnë konfuzion nëse i referohen një shifre bruto apo neto. Portofoli bruto i kredisë nuk duhet të ngatërrohet me vlerën e kredive të shpërndara (shih P1 më poshtë).

- B2 Portofoli qarkullues** – është pjesë e portofolit bruto të kredisë që përfshin vlerën e të gjithë outstanding të kredive të cilat nuk kanë asnjë këst të principalit të vonuar mbi një numër të caktuar ditësh dhe që nuk janë rigrafikuar apo ristrukturuar (shiko B4). Ajo nuk përfshin interesin e përlllogaritur. Një standart 30 ditësh është i zakonshëm, por rregulloret mund ti kërkojnë IMF të përdorë një standart të ndryshëm. IMF duhet të përcaktojë qartë se cili është përkufizimi për portofolin qarkullues.
- B3 Portfoli-në-risk** – vlera e gjithë kredive outstanding që kanë një apo më shumë këste të kapitalit të vonuara më shumë se një numër i caktuar ditësh. Kjo kategori përfshin gjithë bilancin e kapitalit të papaguar, përfshirë këstin e vonuar dhe këstet e ardhshme, por jo interesin e përlllogaritur. Ajo gjithashtu nuk përfshin kreditë e ristrukturuara apo të rigrafikuara. Portofoli në risk zakonisht ndahet në kategori në varësi të kohës së vonesës nga mospagesa e këstit të parë të kapitalit (shih raportin e Portofolit në Risk, Seksioni II)
- B4 Portofoli i ristrukturuar** –bilanci i principalit të të gjithë kredive outstanding që janë negociuar apo modifikuar ose për ta zgjatur ose për ta shtyrë pagesën e këstit të principalit nga data e përcaktuar në kalendarin e shlyerjeve, ose të ndryshojë kushtet origjinale të kredisë. Kjo kategori përfshin gjithashtu kreditë e rifinancuara, të cilat janë kredi që janë shpërndarë për të bërë të mundur shlyerjen e kredive të mëparshme nga klientët, të cilët sidoqoftë nuk do të mund të shlyenin këstet ashtu sic janë parashikuar në kalendarin origjinal.
- B5 Rezerva për humbjet e kredisë** – pjesa e portofolit bruto të kredisë e parashikuar që më parë se të ndodhë humbja si rezultat i mosshlyerjes së kredisë. Kjo kategori përfaqëson vlerën kumulative të provigjoneve për humbjen e kredisë (I6) minus vlerën kumulative të kredive të falura (P5).
Duhet theksuar se rezerva për humbjen e kredisë nuk është një rezervë në kesh por një llogari, e cila mund t'i japë lexuesit informacionin lidhur me masën e humbjeve të pritshme të kredise. Rezerva ndërtohet nga shpenzimet për provigjionet specifike që lidhen me portofolin në risk (B3) apo në disa raste nga shpenzimet për provigjionet përkundër të gjithë portofolit bruto të kredisë (B1).
- B6 Portofoli Neto i Kredisë** – është portofoli bruto i kredisë (B1) minus rezervën për humbjen e kredisë (B5).
- B7 Asetet fikse neto** – vlera e blerjes apo kostoja e të gjithë pasurisë fizike dhe përmirësimeve të pasurisë, mobiljeve dhe pajisjeve që përdoren aktualisht nga IMF (përfshirë edhe gjithë pajisjet e dhuruara) minus vlerën kumulative të të gjithë

shpenzimeve të amortizimit dhe vlerën e aseteve fikse bruto që janë fshirë plotësisht nga bilanci, shitur, ose amortizuar në periudhën akruale po atë të mëparshme. Asetet fikse mund të përfshijnë edhe asetet e patrupëzuara, si psh. investimet e bëra në produkt apo në zhvillimin e IMF, të cilat nuk kanë veti fizike, por përfaqësojnë një përfitim ekonomik në të ardhmen e IMF.

- B8 **Asetet Totale** – përfshijnë të gjithë llogaritë e aseteve të zhveshura nga llogarite kundra asete, si rezerva për humbjen e kredisë dhe amortizimi i akumuluar.
- B9 **Asetet Financiare** – asete jo-fizike vlera e të cilave emërtohet në vlerë monetare. Kjo kategori përfshin arkën, llogaritë bankare, investimet, portofolin neto të kredisë (B6), dhe arkëtimet e tjera. Kjo kategori nuk përfshin asetet fikse neto.
- B10 **Asetet që sjellin të ardhura** – gjithë asetet financiare që fjenerojnë të ardhura financiare. Shembujt përfshijnë investimet dhe portofolin bruto të kredisë (B1). Arka dhe llogarite korente bankare nuk konsiderohen si asete që gjenerojnë të ardhura, nëse një llogari bankare korente, si psh llogaria e depozitave rrjedhëse, nuk ka interes.
- B11 **Depozitat** - vlera totale e fondeve vendosur në një llogari me IMF që mund t'i paguhet depozituesit me kërkesë të tij. Kjo kategori përfshin cdo llogari rrjedhëse apo kursimesh që paguhet kur kërkohet. Ajo gjithashtu përfshin depozitat me afat që kanë një datë të caktuar maturimi.
- B12 **Huamarrjet komerciale** - fondet e marra nga IMF, nëpërmjet një marrëveshje kredie apo marrëveshje tjetër kontraktuale, me interesin e tregut. Huamarrjet komercilale përfshijnë kreditë, linjat e kredive, por nuk përfshijnë depozitat. Ndërsa përkufizimet për nivelin e tregut variojnë, referenca e përbashkët është niveli që paguajnë bankat lokale tregtare për depozitat me afat 90 ditë e lart. IMF duhet të shënojë se çfarë reference përdorin për të përcaktuar nëse një huamarrje është në nivelin e tregut, pra tregtare.
- B13 **Huamarrjet koncensionale** – fonde të marra nga IMF nëpërmjet një marrëveshje kredie apo marrëveshje tjetër kontraktuale me një interes më të ulët se sa ai i tregut (shih B12 për përcaktimin e përqindjes së interesit të tregut). IMF duhet të shënojë çfarë reference përdor për të përcaktuar nëse një huamarrje është nën nivelin e tregut, pra koncesionale.
- B14 **(Total) Detyrimet Financuese** – gjithë detyrimet që përdoren për të financuar asetet financiare të MFI. Detyrimet financuese përfshijnë depozitat (B11) dhe huazimet (B12, B13), por nuk përfshijnë llogaritë për t'u paguar, apo huazimet (apo një pjesë të tyre) që përdoren për të financuar asetet fikse (si financimin e pajisjeve apo hipotekat).
- B15 **Detyrimet totale** – gjithë llogaritë e detyrimeve që përfaqësojnë gjithçka që IMF i detyrohet të tjerëve, përfshirë gjithë depozitat, huatë, llogaritë për t'u paguar apo

llogaritë e tjera të detyrimeve.

- B16 **Kapitali i dhuruar** – donacionet e akumuluar që nuk kanë asnjë përcaktim. IMF përdor metoda të ndryshme për llogaritjen e kapitalit të dhuruar. Për shumicën e institucioneve, kapitali i dhuruar përfshin gjithë donacionet, pavarësisht nga përdorimi i tyre. Për të tjerët, kapitali i dhuruar përfshin vetëm donacionet në natyrë si dhe donacionet për financimin e portofolit bruto të kredisë apo asetet fikse. Gjithë donacionet për shpenzimet operationale dhe jo-operationale përfshihen në fitimin e grumbulluar. IMF duhet të përcaktojë se çfarë donacionesh përfshihen në kapitalin e dhuruar.
- B17 **Kapitali total** – asete totale minus detyrime totale. Kjo është gjithashtu edhe shuma e të gjitha llogarive të kapitalit pa shpërndarjen e ndonjë kapitali si psh dividetëve, riblerje aksionesh, apo pagesa të tjera në kesh bërë aksionerëve.

Terma shtesë

Ka një numër termash që përdoren shpesh nga IMF dhe janë të nevojshëm për të llogaritur treguesit financiarë. Shumë nga këto terma do shfaqen në raportet tremujore apo vjetore të IMF apo në raportin e portofolit.

- P1 **Vlera e kredive të shpërndara** – vlera e gjithë kredive të shpërndara gjatë periudhës, pavarësisht nëse ato janë qarkulluese apo jo-qarkulluese apo të fshira nga bilanci. Kjo vlerë nuk duhet të ngatërrohet me portofolin bruto të kredisë (B1), i cili mund të jetë disa herë më i vogël se sa vlera e shpërndarë.
- P3 **Numri i kredive të disbursuara** – numri i kredive të dhëna gjatë periudhës. Për IMF që përdorin një metodologji të kredisë në grup, numri i kredive duhet t'i referohet numrit të individëve që marrin pjesë në kredinë në grup, nëse IMF nuk bën një përkufizim të ndryshëm nga ky.
- P3 **Numri i kredive outstanding** – numri i kredive që nuk janë shlyer plotësisht apo nuk janë falur, dhe në këtë mënyrë janë pjesë e portofolit bruto të kredisë (B1). Sic është theksuar më sipër për IMF që përdorin metodologjinë e kredisë në grup ky term përfshin cdo individ që është përgjegjës për shlyerjen e një pjese të kredisë në grup, nëse nuk përkufizohet ndryshe.
- P4 **Vlera e shlyerjeve të vonuara** – shuma e gjithë pagesave të principalit të vonuar. Kjo kategori nuk përfshin interesin e vonuar. Kjo kategori quhet edhe vonesat totale dhe nuk duhet ngatërruar me portofolin në risk (B3).
- P5 **Vlera e kredive të fshira nga bilanci** – vlera e kredive, që për arsye kontabiliteti quhen të pashlyeshme. Procesi i njohjës së një kredie si të pashlyeshme quhet “falje” ose “fshirje nga bilanci”. Një kredi e fshirë nga bilanci është një procedurë

kontabël që heq bilancin outstanding të një kredie nga portofoli bruto i kredisë (B1) dhe nga rezerva e humbjes së kredive (B5). Në këtë mënyrë kjo fshirje nuk ndikon në bilancin e portofolit neto të kredisë (B6), në asetet totale (B8), apë në ndonjë llogari kapitali, nëse rezerva për humbjet e kredisë nuk ka qenë e mjaftueshme për të mbuluar shumën e fshirë nga bilanci. Pjesa më e madhe e IMF kanë politika të cilat kërkojnë fshirjen e kredive të vonuara pas një numri të caktuar ditësh. Duhet theksuar se kreditë e fshira nga bilanci nuk duhet të ndikojë në përpjekjet e IMF për të mbledhur kreditë e pashlyera apo në detyrimin e klientit për të paguar. Nuk është e jashtëzakonshme që IMF të mund të mbledhë kreditë pasi ato janë fshirë nga bilanci.

- P6 **Portofoli korent** – vlera outstanding e gjithë kredive që nuk kanë ndonjë këst principali të vonuar. Kjo kategori nuk përfshin interesin e përlloritur.
- P7 **Numri i huamarrësve aktivë** – numri i individëve të cilët aktualisht kanë një bilanc kredie outstanding me IMF apo që janë përgjegjës për shlyerjen e një pjese të portofolit bruto të kredisë. Ky numër duhet të bazohet më tepër në huamarresit individuale se sa në numrin e grupeve.
- P8 **Numri i depozituesve apo kursimtareve** – numri total i individëve të cilët aktualisht kanë fonde të depozituara në një IMF, të cilat IMF është i detyruar t’ia kthejë. Ky numër aplikohet vetëm tek depozitat që mbahen nga IMF, jo për depozitat e mbajtura në institucionet e tjera nga klientët e IMF. Numri duhet të bazohet në individë jo në numrin e grupeve. Është e mundur që një llogari e vetme depozite të përfaqësojë shumë depozitues.
- P9 **Numri i kursimtarëve facilitated** – Numri total i individëve me llogari kursimi në një institucion tjetër që e ka lehtësuar IMF, por që nuk është e gatshme t’i paguajë. Shumë IMF punojnë me palë të treta, zakonisht një bankë tregtare ose vetë me një grup huamarrësish, në të cilën klientët e tyre huamarrës mbajnë llogaritë e kursimeve të cilat mund ose jo të përdoren si kolateral nga IMF. Në këtë dokument, kësaj i referohemi si kursime lehtësuese. Kur prezantohet numri i depozituesve, IMF duhet të ketë kujdes të mos i përfshijë ato si depozitues (P8).
- P10 **Kursimet e detyrueshme** – vlera e kursimeve që një klient i IMF është i detyruar të depozitojë si kusht për një kredi ekzistuese apo të ardhshme. Kursimet e detyrueshme mund të jenë ose një depozitë e mbajtur nga IMF ose një llogari kursimesh e mbajtur jashtë institucionit të mikrofinancës.

- P11 Kursimet vullnetare** – vlera e kursimeve që ka një klient i IMF, por që nuk është kusht për një kredi ekzistuese apo të mundshme në të ardhmen. Ato mund të jenë depozita të mbajtura nga IMF apo kursimet lehtësuese e mbajtur jashtë IMF si një pjesë e shërbimeve financiare të IMF.
- P12 Numri i klientëve aktive** – numri i individëve të cilët janë huamarrës apo depozitues aktivë, ose të dyja bashkë. Individët të cilët kanë disa kredi apo llogari në IMF duhet të konsiderohen si një klient i vetëm. Individët të cilët nuk marrin ndonjë shërbim të drejtpërdrejtë nga IMF nuk përfshihen, psh ato me kursime lehtësuese.
- P13 Numri i klientëve** – numri total i klientëve aktive plus numrin e individëve të cilët nuk janë as huamarrës as depozitues aktivë, por që janë anëtare apo ata që në një mënyrë përdorin shërbimet e IMF. Shpesh këtyre i referohemi si *anëtare*. *Kjo kategori mund të përfshijë edhe klientët me kursime lehtësuese.*
- P14 Numri i oficerëve të kredisë** – numri i personelit, aktiviteti kryesor i të cilëve është menaxhimi direkt i një pjese të portofolit bruto të kredisë. Oficeri i kredisë është anëtar stafi, përgjegjës direkt për dhënien dhe monitorimin e kredisë së një klienti. Termi “oficer kredie” i referohet “personelit të terrenit” i cili është në kontakt direkt me klientin, dhe nuk i referohet stafit administrativ apo analistëve, të cilët analizojnë kreditë pa kontaktin direkt me klientin. Oficerët e kredisë përfshijnë punonjësit me kontratë të cilët mund të mos jenë pjesë e stafit të përhershëm, por kontraktohen në baza të rregullta me kapacitetin e oficerit të kredisë. Tek oficerët e kredisë përfshihen punonjësit me kontratë që mund të jenë ose jo pjesë e stafit të përhershëm, por që janë punësuar me kontratë mbi baza të rregullta me kapacitetin e oficerit të kredisë.
- Numri i oficerëve të kredisë raportohet mbi bazën e ekuivalentit me kohë të plotë. Në rastin kur një anëtar stafi menaxhon disa kredi, por në të njëjtën kohë ka edhe detyra të tjera (psh, supervisor), ky tregues duhet të përfshijë një fraksion < 1 që përfaqëson sasinë e kohës që harxhon duke bërë detyrën e oficerit të kredisë. Psh, një IMF që ka 5 oficerë kredie dhe një supervisor që menaxhon disa kredi mund të raportojë $5 \frac{1}{2}$ si numër oficerësh kredie.
- P15 Numri i personelit** – numri i individëve të punësuar nga IMF. Ky numër përfshin punonjësit me kontratë apo këshilltarët, të cilët ia dedikojnë pjesën më të madhe të kohës IMF, megjithëse ato nuk janë në listën e punonjësve të IMF. Ky numër duhet të shprehet në ekuivalencë të kohës së plotë, cka do të thotë që një këshilltar që harxhon $\frac{2}{3}$ e kohës në IMF duhet të konsiderohet si punonjës me $\frac{2}{3}$ e kohës të plotë.

II. Raportet Financiare

Ky seksion përfshin një listë të raporteve më të përdorshëm në industrinë e mikrofinancës. Qëllimi i këtij seksioni është të përcaktojë formulat dhe qëllimet e raporteve kryesore dhe të shpjegojë disa nga çështjet kyc që lidhen me cdo raport, përfshirë disa çështje të llogaritjeve të përgjithshme. Raportet janë të ndara në 4 kategori të quajtura:

Qëndrueshmëria/ Përfitueshmëria

Menaxhim i Aseteve/Detyrimeve

Cilësia e portofolit

Efienca/Produktiviteti

Kjo listë raportesh është padyshim shumë e lodhshme. Disa raporte janë përfshirë këtu sepse janë shumë të përdorshme, të tjerat për shkak të dykuptimeve në përdorim. IMF dhe analistët inkurajohen të përdorin ato raporte të cilat ato e ndjejnë që janë të përshtatshme dhe përkatëse për të matur performancën. **Kjo listë raportesh nuk është e detyrueshme të përdoret si model raportimi.**

Kontribuesit e këtij seksioni janë të ndërgjegjshëm se IMF kanë përkufizime që ndryshojnë nga ato që po paraqiten këtu. Shpresojmë që përkufizimet e mëposhtme të shërbejnë si një pikë referimi për këtë industri, në mënyrë të tillë që ato që përdorin formula apo përkufizime alternative të mund të shpjegojnë ndryshimin, duke i krahasuar ato me përkufizimet e mëposhtme. Për cdo raport ka një kod reference, një formulë dhe shpjegimi i qëllimit.

Cështje të llogaritjeve

Vjetorizimi

Nëse nuk kërkohet ndryshe, supozohet se gjithë të llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve të përdorur në tregues të ndryshëm janë dhënë në baza vjetore. Kur llogarisim raportet financiare në seksionin III, supozohet se pasqyra e të ardhurave përfaqëson një vit. Nëse jo, atëherë shifrat në pasqyrën e të ardhurave duhet të vjetorizohen (të jepen mbi baza vjetore) përpara se ato të krahasohen me shifrat e vitit paraardhës apo me IMF e tjera.

Formula e anualizimit të një numri është:

$$AA = [A \times (12/M)]$$

Ku:

AA = Shuma e vjetorizuar

A = Shuma për periudhën

M = Numri i muajve për periudhën

Mesatarja

Shumë tregues financiarë kërkojnë një mesatare për llogarinë e bilancit, si psh outstanding i portofolit neto të kredisë. Mesatarja për një periudhë (psh një vit) mund të llogaritet duke mbledhur shumën e fillimit të periudhës me atë të fundit dhe duke e pjestuar rezultatin me dy.

$$P^{avg} = [(P^0 + P^1)/2]$$

Fatkeqësisht, një llogaritje e tillë e thjeshtë mesatarje mund të japë një numër jo të saktë. Kjo mund të ndodhë vecanërisht në institucionet, portofoli i kredisë së të cilëve rritet me shpejtësi apo në institucionet që kanë luhajtje të mëdha sezonale në aktivitetin huadhënës. Mesataret për periudhën kanë më shumë kuptim kur ato llogariten mbi baza mujore apo tremujore. Kur përdorim mesatare të tilla, numëruesi është bilanci i celjes plus shumën e bilancit në fund të një periudhe të cdo nën-periudhe, ndërsa emëruesi është numri i nën-periudhave plus një. Psh, një mesatare tremujore do të llogaritej si më poshtë:

$$P^{avg} = \frac{(P^0 + P^1 + P^2 + P^3 + P^4)}{(4+1)}$$

Qëndrueshmëria/Përfitueshmëria

R1	Kthimi nga Kapitali (ose rendimenti i kapitalit)	<u>E ardhura operationale neto</u> Mesatare e Kapitalit ???? do përfshihen taksat?	Llogarit nivelin e kthimit nga kapitali mesatar për periudhën (ose rendimentin e kapitalit). Për shkak se numëruesi nuk përfshin zërat jo-operationale si donacionet, ky raport shpesh përdoret për të treguar rendimentin komercial. MFI që nuk përdorin mesataren e kapitalit si emerues, duhet të tregojnë nëse ai bazohet në kapitalin në fillim apo në fund të vitit.
	Kthimi nga Kapitali i Axhustuar	<u>E ardhura operationale neto e axhustuar</u> Mesatare e Kapitalit	Ky tregues mund të llogaritet mbi bazën e axhustimeve për të treguar efektin e subvencioneve, inflacionit, provigjonit për humbjet e kredisë, dhe gjithcka tjetër që nuk përfshihet normalisht në të ardhuren neto operationale. Axhustimet do t'i shikoni në Seksionin III

R2	Kthimi nga asetet (ose rendimenti i asetëve)	<u>E ardhura operacionale neto</u> Mesatare e Asetëve ??? do përfshihen taksat ?	Mat se në çfarë niveli i përdor IMF asetet e veta totale për të gjeneruar të ardhura.
	Kthimi nga asetet i axhustuar	<u>E ardhura operacionale neto e axhustuar</u> Asetet mesatare	Ky tregues mund të llogaritet mbi bazën e axhustimeve për të treguar efektin e subvencioneve, inflacionit, provigjionit për humbjet e kredisë, dhe gjithçka tjetër që nuk përfshihet normalisht në të ardhurën neto operacionale. Axhustimet do t'i shikoni në Seksionin III
R3	Vetë-qëndrueshmëria Operacionale	<u>Të ardhura Operacionale</u> (Shpenzime Financiare + shpenzime mbi provigjionet për humbjet e kredisë + shpenzime operacionale)	Mat se sa mirë një IMF mund të mbulojë kostot e tij me të ardhurat operacionale. Vec shpenzimeve operative, rekomandohet të përfshihen në këtë llogaritje edhe shpenzimet financiare dhe shpenzimet për provigjionet për humbjet e kredive, pasi ato janë një kosto normale (dhe e rëndësishme) të veprimtarisë së institucionit
R4	Marzhi i fitimit	<u>Të ardhura operacionale neto</u> Të ardhura Operacionale	Mat se çfarë përqindje e të ardhurave operacionale mbetet pasi janë paguar të gjithë shpenzimet financiare, të provigjioneve mbi humbjet e kredive dhe atyre operacionale.
R5	Vetë-mjaftueshmëria financiare	<u>Të ardhura operacionale të axhustuara</u> Shpenzime Financiare + Shpenzimet për provigjionet mbi humbjet e kredisë + Shpenzime operacionale të axhustuara	Mat se sa mirë një IMF mund të mbulojë kostot e tij, duke marrë në konsideratë një sërë axhustimesh për të ardhurat dhe shpenzimet operacionale. Qëllimi i shumicës së këtyre axhustimeve është të modelohet se sa mirë i mbulon IMF kostot e tij nëse veprimet e tij janë të pasubvencionuara dhe do të do të financonte zgjerimin e tij me detyrime komerciale. Axhustimet janë përshkruar

Menaxhimi i Aseteve /Detyrimeve

R6	Rendimenti i portofolit bruto	<u>Të ardhura financiare në kesh nga portofoli i kredisë</u> Mesataren e portofolit bruto të kredisë	Tregon aftësinë e portofolit bruto të kredisë për të gjeneruar të ardhura financiare në kesh nga interesat, dhe komisionet. Nuk përfshihen të ardhurat që janë përlllogaritur por nuk janë paguar në kesh, apo të ardhurat jo-kesh në formën e ceqeve të vonuar, kolateralit të marrë por të pashitur, etj.
R7	Current ratio	<u>Asete afat-shkurtëra</u> Detyrimet afat-shkurtëra	Mat se sa mirë MFI përshtat maturimin e asetëve dhe detyrimeve të tij. Afat-shkurtëra janë asetet apo detyrimet apo një pjesë e tyre që kanë një datë maturimi, ose mund të jenë gati për t'u konveruar në kesh brenda 12 muajsh.
R8	Gapi i rendimentit	<u>Rendimenti mbi portofolin neto</u> Rendimenti i pritshëm vjetor	Krahason të ardhurat aktuale në kesh me të ardhurat që priten të realizohen nën kushtet e kontratës së kredisë. Ndërsa një gap është normal, një gap i rëndësishëm rendimenti (> 10%) mund të tregojë që ka pagesa të vonuara, mashtrime, ineficencë apo gabime kontabiliteti. Në këtë formulë “rendimenti i pritshëm vjetor” do të thotë nivel interesi efektiv i kontratës së kredisë (the declining-balance-equivalent rate) për një periudhë të vetme pagese, shumëzuar me numrin e periudhave në një vit ¹
R9	Raporti i	Shpenzimet e interesit dhe	Tregon nivelin e interesit që paguan IMF

¹ Compounding is not used. Thus, if the effective monthly rate is 3%, then the expected annual yield is $(3\% \times 12 \text{ months}) = 36\%$, not $1.03^{12} - 1 = 42.58\%$

	shpenzimeve të financimit	dhe komisioneve mbi <u>detyrimet financuese</u> Mesatarja e portofolit bruto të kredisë	për financimin e aseteve të tij financiare. Ky raport mund të krahasohet me rendimentin e portofolit bruto për përcaktimin e marzhit të interesit.
R10	Raporti i kostos së fondeve	Shpenzimet e interesit dhe komisioneve mbi <u>detyrimet financuese</u> Mesatarja e detyrimeve financuese	Raporti jep një nivel të përbërë interesi për gjithë detyrimet financuese të IMF. Detyrimet financuese nuk përfshijnë interesin e paguar apo interesin mbi kreditë për financimin e aseteve fikse.

Cilësia e portofolit

R11	Raporti i Portofolit Në risk	<u>Portofoli në risk (X ditë)</u> Portofoli bruto i kredisë	Matja më e pranueshme e cilësisë së portofolit të kredisë. Portofoli në risk është shuma e principalit outstanding të të gjithë kredive që kanë një ose më shumë këste të vonuara me një numër të caktuar ditësh. Kur i referohemi Portofolit në Risk, IMF duhet gjithnjë të specifikojë numrin e ditëve. IMF duhet të përcaktojë nëse kreditë e rigrafikuara janë përfshirë në llogaritje apo jo. Disa IMF automatikisht përfshijnë kreditë e rigrafikuara në portofolin e tyre në risk. Kjo praktikë reflekton besimin se kreditë e rigrafikuara kanë risk më të lartë se ato në kohë.
R12	Raporti i kredive të fshira nga bilanci	<u>Vlera e kredive të fshira nga bilanci</u> Mesatarja e portofolit bruto të kredisë	Përfaqëson përqindjen e kredive të IMF që janë fshirë nga bilanci i portofolit bruto të kredisë, për shkak se nuk mendohet që ato të shlyhen. Një raport i lartë mund të tregojë një problem në përpjekjet e IMF për grumbullimin e kredive. Megjithatë politikat e IMF për fshirjet nga bilanci ndryshojnë, gjë e cila e bën të vështirë krahasimin. Si rezultat, analistët mund ta prezantojnë këtë raport mbi bazën e axhustimeve për të dhënë një trajtim uniform të kredive të fshira nga
	Raporti i kredive	<u>Vlera e axhustuar e kredive të fshira nga</u>	

	të fshira i axhustuar	<u>bilanci</u> Mesatarja e portofolit bruto të kredisë	bilanci. (Shih Seksionin III)
R13	Raporti i mbulimit të riskut	<u>Rezerva për humbjen e kredisë</u> Portofoli në risk > X ditë	Tregon se c'pjesë e portofolit në risk mbulohet nga rezerva për humbjet e kredisë që ka IMF. Është një tregues që jep qartë se sa i përgatitur është institucioni të përballojë humbjet e kredive në rastin e skenarit më të keq. IMF duhet të bëjnë provigjione sipas klasifikimit të portofolit në risk: sa më e vjetër të jetë kredia e pashlyer aq më e lartë është rezerva për humbjen e kredisë. Për shembull, një raport për portofolin në risk > 90 ditë mund të jetë rreth 100%, ndërsa raporti për portofolin në risk > 30 ditë duhet të jetë shumë më i vogël. Kështu raporti i mbulimit të riskur prej 100% nuk është domosdoshmërisht optimal.

Eficienta/Produktiviti

Këto indikatorë reflektojnë se me sa eficientë i përdor IMF burimet e saj, në vecanti asetet dhe personelin. IMF përdorin tregues të ndryshëm eficientie dhe produktiviteti, duke i përshtatur ato për të reflektuar strukturën e tyre organizative, linjat e prodhimit, dhe prioritetet e monitorimit. Në llogaritjen e këtyre treguesve, IMF duhet të zgjedhin me kujdes se kë emëruet duhet të përdorin. Emëruet më të përdorshëm në lidhje me asetet janë (1) portfoli bruto i kredisë (2) asetet qarkulluese dhe (3) mesatarja e aseteve totale. Pjesa më e madhe e IMF zgjedhin të përdorin mesataren e portofolit bruto të kredisë sepse ato llogaritin tregues të tjerë duke përdorur këtë emëruet. Megjithatë ka argumente të forta për të përdorur asetet qarkulluese, që është standarte për industrinë e bankave tregtare, apo për mesataren e aseteve totale, e cila është më lehtësisht e matshme nga të treja. Përdorimi i mesatares së aseteve totale si emëruet për raportet e eficientës/produktivitetit është më i saktë për IMF që menaxhojnë depozita apo/dhe llogari aksionesh plus aktivitetit të kredisë. Sidoqoftë, IMF duhet të përdorë gjithnjë të njëjtin emëruet. Për hir të një prezantimi të thjeshtuar, më poshtë do të përdorim portofolin bruto të kredisë; megjithatë asterisk (*) në emëruetin e disa raporteve tregon që mund të përdoret edhe mesatarja e aseteve totale.

IMF duhet të vendosin nëse duan të përdorin numrin e personelit apo numrin e oficerëve të kredisë si bazë referimi për burimet njerëzore. Qëllimi për konsiderimin e oficerëve të kredisë si një kategori më vete është se ata shpesh janë të angazhuar direkt në detyra që gjenerojnë të ardhura (psh. dhënia dhe mbledhja e kredive). Megjithatë ka një tendencë për përdorimin e personelit total në llogaritjen e treguesve të produktivitetit, duke pasur parasysh edhe faktin që detyrat e oficerit të kredisë mund të përplasen me ato të stafit administrativ.

R14	Produktiviteti i oficerit të kredisë	<u>Numri i huamarrësve aktive</u> Numri i oficerëve të kredisë	Mat ngarkesën mesatare për çdo oficer kredie, sic përcaktohet në Seksionin II. Ky është një tregues i përdorshëm, por është e vështirë të krahasosh IMF e ndryshme me këtë tregues, në rastet kur ndryshon përkufizimi i tyre për oficerin e kredisë. IMF mundet të zëvendësojnë (1) numrin e kredive outstanding me numrin e huamarrësve aktive, dhe (2) numrin e oficerëve që kryejnë shërbime financiare me numrin e oficerëve të kredisë. Pavarësisht nga të gjitha, IMF duhet të shpjegojnë përkufizimin e tyre për emëruetin dhe numëruetin.
-----	--------------------------------------	---	--

R15	Produktivite ti i personelit	<u>Numri i huamarrësve aktivë</u> Numri i personelit	Mat produktivitetin e përgjithshëm të burimeve totale njerëzore të IMF në menaxhimin e klientëve, të cilët kanë një kredi në vazhdim dhe që kontribuojnë në këtë mënyrë në të ardhurat financiare të IMF.
		<u>Numri i klientëve aktive</u> Numri i personelit	IMF mund të dëshirojë të masë edhe produktivitetin e përgjithshëm të personelit të IMF në lidhje me menaxhimin e klientelës, përfshirë këtu huamarrësit, depozituesit, dhe klientët e tjerë. Ky tregues është ndër më të përdorshmit për të krahasuar IMF.
R16	Mesatarja e masës së kredisë së disbursuar	<u>Vlera e kredive të disbursuara</u> Numri total i kredive të disbursuara gjatë periudhës	Mat masën mesatare të kredisë që i është disbursuar klientëve. IMF duhet të jenë të kujdesshëm të bëjnë dallimin midis masës së kredive të disbursuara dhe masës së kredive në vazhdim (shih R17).
R17	Mesatarja e masës së kredisë në vazhdim	<u>Portofoli bruto i kredisë</u> Numri i kredive në vazhdim	Mat bilancin e mesatares së kredisë në vazhdim sipas klientëve, e cila mund të jete më pak e rëndësishme se sa mesatarja e masës së kredisë së disbursuar. Shpesh ky tregues krahasohet me GDP për kokë për të përcaktuar se në çfarë niveli IMF është fokusuar tek klientët me të ardhura të ulta.
R18	Treguesi i shpenzimeve Operative	<u>Shpenzime Operative</u> Mesatarja e portofolit bruto të kredisë *	Përfshin të gjithë shpenzimet administrative dhe të personelit, dhe është një nga treguesit që përdoret më me eficientë. Duhet bërë kujdes kur përdoret ky tregues për të krahasuar IMF. IMF apo ato institucione që japin kredi më të vogla do të krahasohen në mënyrë të pafavorshme me të tjerët, megjithëse mund t'i shërbejnë tregut të tyre në mënyrë eficiente. Ndërsa IMF që ofrojnë kursime dhe shërbime të tjera do të krahasohen edhe ato në mënyrë të pafavorshme me ato që nuk i ofrojnë këto shërbime, nëse përdoret si emërues

			portofoli bruto i kredisë; pra mesatarja e asetëve totale është një emërues më i përshtatshëm për ndërmjetësimet financiare kur llogaritet treguesi i shpenzimeve operacionale.
R19	Kostoja për huamarrës	<u>Shpenzime operative</u> Numri mesatar i huamarrësve aktive	Ky është një tregues shumë i rëndësishëm eficence për IMF dhe i lejon ato të përcaktojnë koston mesatare për mbajtjen e një huamarrësi apo klienti aktiv.
	Kostoja për klient	<u>Shpenzime operative</u> Numri mesatar i klientëve	IMF mund të zëvendësojnë numrin e kredive aktive si emërues në vend të emëruesit për të parë koston për kredi aktive në vazhdim. Është gjithashtu e rëndësishme kur krahason me GNP për kokë për të vlerësuar Eficencën e IMF në kontekstin lokal. Për asye se ata marrin më shumë parasysh klientët se sa shumat, këto tregues kanë avantazhin që nuk i paragjykojnë IMF që ofrojnë kredi dhe llogari depozitash më të vogla.
R20	Tregues të tjerë shpenzimesh	<u>Cdo shpenzim</u> Mesatarja e portofolit* bruto të kredisë	Treguesit e shpenzimeve mund të krijohen për pothuajse cdo llogari shpenzimesh që gjendet në pasqyrën e të ardhurave. Qëllimi është t'i lejohet IMF apo analistëve të analizojnë rritjen apo uljen e shpenzimeve të vecanta për një periudhë të caktuar kohë apo për një grup të caktuar.

III. Axhustimet

Analistët financiarë shpesh llogarisin një sërë axhustimesh, shumica e të cilave përbëjnë një shtesë analitike të shpenzimeve që ka raportuar IMF. Katër janë grupet më të përdorshëm të axhustimeve:

- Axhustimet për subvencionet, ku përfshihen:
 - Axhustimet për koston e subvencionuar të fondeve, dhe
 - Axhustimet për subvencionet në natyrë
- Axhustimet për inflacionin
- Axhustimet për kreditë jo-performuese, ku përfshihen
 - Axhustimet për rezervën e humbjes së kredisë dhe shpenzimet për provigjonet,
 - Axhustimet për kreditë e fshira nga bilanci, dhe
 - Kthimi/anullimi i interesit të përlllogaritur mbi kreditë jo-performuese
- Axhustimet për humbjet/fitimet nga kursi i shkëmbimit

Cdo përpjekje për të standartizuar përkufizimet mbi axhustimet duhet të ketë parasysh dy nivele: (1) si llogaritet cdo axhustim individual, dhe (2) cilat kombinime të axhustimeve individuale nënkuptohen kur përdorim një term, si psh. “kthimi nga asetet i axhustuar”.

(1) Në këtë dokument nuk ka asnjë përpjekje për të dhënë një metodë standarte llogaritjeje për cdo rregullim individual; por më tepër është dhënë një metodë e përgjithëshme llogaritje e cdo axhustimi. Nëse një analist përdor emrin e njërit prej këtyre rregullimeve, atëherë ky axhustim duhet të llogaritet sipas mënyrave të përshkruara në këtë dokument. **Cdo raport që i referohet rregullimeve individuale duhet të përshkruajë metodën e llogaritjes së përdorur. Përshkrimi duhet të jetë i saktë, sidomos kur metoda e përdorur ndryshon thelbësisht nga ajo e përshkruar në këtë dokument.**

(2) Kthimi nga asetet apo kapitali i axhustuar (R1, R2) në përgjithësi përfshin efektin e një sërë rregullimesh. Nuk është praktike të përcaktohet një paketë standarte axhustimesh që do të nënkuptohet sa herë që do të përdoren këto tregues. Analistë të ndryshëm përdorin axhustime të ndryshme për qëllimet e tyre për të arritur tek kthimi i axhustuar nga asetet apo kapitali.² Nga kjo pikëpamje, **kurdo që një raport i referohet kthimit të axhustuar nga asetet apo kapitali, duhet të bëhet një përcaktim i saktë i cdo axhustimi individual të përfshirë në analizat për atë tregues.**

Axhustimet për subvencionin

Axhustimet për subvencionin bëhen për dy qëllime. *Së pari*, IMF ndryshojnë përsa i përket shumës së subvencionit që ato marrin, nëse marrin një të tillë. Disa IMF nuk marrin

² Psh, një database si *MicroBanking Bulletin*, qëllimi i të cilës është krahasimi mund të dojë të axhustojë rezervën për humbjen e kredisë në një linjë më një politikë standarte. Nga ana tjetër një analist i një IMF të vecantë mund të mëndojë që politika e tij lidhur me rezervat, megjithëse “jo-standarte” është shumë e përshtatshme, dhe kështu nuk është e nevojshme të bëhet ndonjë axhustim për rezervat.

subvencion. Në këtë mënyrë axhustimet për subvencionin bëjnë të mundur një krahasim më kuptimplotë të rezultateve midis IMF me shumën e ndryshme subvencioni. *Së dyti*, industria ka pranuar që, në një afat të gjatë, IMF duhet të jenë në gjendje të zhvillojnë aktivitetin e tyre pa marrë subvencione, duke u mbështetur në burimet komerciale dhe investimet private me përqindjet bankare. Një axhustim që përjashton efektin e subvencionit tregon se sa pranë është IMF në pasjen e një biznesi që mund të zgjerohet në një ambient komercial pa nevojën e subvencioneve.

Axhustimet për subvencionin nuk përfshihen në pasqyrat normale financiare të IMF. Ato janë të ardhura apo shpenzime hipotetike që i përdorin analistët apo menaxherët kur llogarisin tregues dhe raporte të vecanta. IMF kanë të përbashkët përdorimin e dy llojeve të axhustimeve për subvencionin.

A1 Axhustimi për koston e subvencionuar të fondeve Ky axhustim përqëndrohet në ndryshimin midis shpenzimeve financiare të IMF dhe shpenzimeve financiare që ai do të paguajë nëse gjithë detyrimet financuese do të vlerësoheshin me cmimin e tregut. Një mënyrë e përbashkët për ta bërë këtë është të shumëzohet mesatarja e detyrimeve financiare me një cmim të fshehur—me interesin e tregut — dhe pastaj të zbriten shpenzimet financiare aktuale. Diferenca është shumën e axhustimit dhe trajtohet si një shpenzim.³

Asnjë nivel i fshehur më vete nuk është i aplikueshëm për të gjithë rrethanat. Shumë analistë përdorin si cmim të fshehur nivelin që bankat lokale paguajnë për depozitat me afat 90-ditë e lartë.⁴

A2 Axhustimet e subvencionit në natyrë Donatorët shpesh i japin IMF, jo vetëm fonde por edhe mallra apo shërbime pa kosto apo nën koston e tregut. Një shembull i zakonshëm i këtyre subvencioneve në natyrë janë kompjuterat, shërbimet e konsulencës, zyrat, shërbimet menaxheriale falas. Axhustimi i subvencionit në natyrë është diferenca midis çfarë IMF paguan aktualisht për mallrat apo shërbimet dhe çfarë duhet të paguante për të njëjtat mallra apo shërbime në tregun e lirë.

Nëse marrëveshja me donatorit kërkon që IMF të pranojë një mall apo një shërbim të cilin nuk ka mundësi ta blejë, atëherë ato nuk do të trajtohen si subvencion në natyrë në llogaritjen e axhustimit.

Disa IMF të reja marrin shërbime falas nga një menaxher i paguar shumë shtrenjë, shpesh një menaxher i huaj. Nëse analisti beson se IMF shpejt do të jetë në gjendje të përdorë një menaxher më të lirë,

³ Disa analistë aplikojnë axhustimin për koston e fondeve vetëm për kreditë në nivelin e interesit të cilave është më i lartë se sa një nivel i caktuar (psh 2-5%) nën nivelin në hije komercial.

⁴ Line 160 of the International Monetary Fund's *International Financial Statistics*

atëherë bën një axhustim, jo për koston e menaxherit të dhuruar, por për koston e pritshme të një menaxheri lokal.

Ashtu sic është theksuar edhe në përkufizimet dhe raportet e mësipërme, performanca financiare e MFI matet mbi bazën e të ardhurave operacionale neto, që përjashton donacionet. Ky përjashtim mund të mendohet si forma e tretë e axhustimit të subvencionit.

Axhustimi për Inflacionin

Në sektorin privat, kapitali zakonisht konsiderohet të jetë forma më e shtrenjtë e financimit; investitorët kërkojnë një fitim më të madh se sa huadhënësit, sepse ata ndërmarrin një risk më të madh. Në të kundërt, shumë IMF nuk duhet të paguajnë për financimin e kapitalit të tyre (përjashtohen këtu kooperativat financiare dhe korporatat me investitues të motivuar komercialisht) Arsytimi përtej axhustimit për inflacionin është se një IMF duhet minimalisht të ruajë vlerën e kapitalit të tij ndaj humbjes për shkak të inflacionit. Inflacioni prodhon një humbje në vlerën reale (fuqia blerëse) të kapitalit. Axhustimi për inflacionin e njeh dhe e vlerëson këtë humbje.

Ndryshe nga axhustimi për subvencionet, regjistrimi i axhustimit të inflacionit në pasqyrat financiare të IMF është i njëjtë në shumë vende të botës dhe mbështetet nga standartet ndërkombëtare të kontabilitetit. Seksioni 29 i Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit mandaton përdorimin e kontabilitetit mbi bazën e axhustimeve të kontabilitetit sidomos në vendet me inflacion të lartë. Në vendet me inflacion të ulët, axhustimi i inflacionit rrallë përfshihet në pasqyrat financiare të biznesit.

A3 Axhustimi i inflacionit Ka shumë metoda të axhustimit të inflacionit. Të gjitha metodat përdorin disa versione të së njëjtës mënyrë: asetet fikse neto (B7) zbriten nga kapitali (B17), dhe rezultati shumëzohet me nivelin e inflacionit për periudhën.⁵ Shuma e axhustimit të inflacionit për një periudhë trajtohet si një rritje në shpenzimet financiare të IMF. Axhustimet e inflacionit përfshihen në pasqyrat financiare të IMF dhe mbarten nga viti në vit, dhe plus krijimit të një shpenzimi në pasqyrën e të ardhurave, ai gjithashtu do të gjenerojë një rezervë në llogarinë e kapitalit të bilancit. Kjo rezervë do të reflektojë shumën e fitimit të akumuluar të IMF që është konsumuar si efekt i inflacionit.

Kurdo që përdoret një tregues i cili përfshin “axhustimin e inflacionit” axhustimi duhet ose (a) të bazohet mbi sistemin kombëtar të kontabilitetit mbi bazën e inflacionit, ose (b) të përdorë një axhustim analitik të kapitalit të ngjashëm me atë të përshkruar më sipër. Humbja në vlerën reale të kapitalit për shkak të inflacionit nuk kapet mjaftueshëm duke riformuluar pasqyrat financiare në

⁵ *Disa* analistë përdorin vlerën e fillimit të periudhës për kapitalin dhe asetet fikse, ndërsa të tjerë përkrahin idenë e përdorimit të mesatareve të periudhës. Të njëjtat objektiva mund të arrihen duke zbritur detyrimet nga asetet financiare.

kushtet e një monedhe lokale konstante apo valute me inflacion të ulët.

Axhustimet për kreditë jo-performuese

Trajtimi që i bën IMF kredive jo-performuese mund të ketë një impakt të madh në paraqitjen e shëndetit financiar të tij. IMF ndryshojnë shumë në politikat e tyre kontabël lidhur me shpenzimet për provigjonet për humbjet e kredisë, kreditë e fshira nga bilanci, dhe nga përlllogaritja e të ardhurave nga interesi. Analistët i axhustojnë këto llogari për të krahasuar IMF dhe/ose për të eliminuar një shkatërrim material në pasqyrat financiare që mund të rezultojë nga një trajtim jo realist i portofolit jo-performues. Ka tre tipe kryesore të axhustimit të portofolit:

- A4 Axhustimi për rezervën për humbjet e kredisë dhe shpenzimet e provigjonit Analistët shpesh axhustojnë rezervën për humbjen e kredisë së IMF (B5) për ta vënë atë në një linjë me politikat e standarteve të kontabilitetit, apo me nivelin që është i mjaftueshëm për riskun e një IMF të vetme. Për të axhustuar rezervën në bilanc, analistët duhet të bëjnë një axhustim për shpenzimin për provigjionin e humbjes së kredive (I6) që kalon në këtë rezervë.
- Një politikë e përdorur shpesh—që këtu përmendet si shembull—është axhustimi i rezervave, që ato të mbulojnë 50 % të bilancit outstanding për kredite me 91-180 ditë vonesë dhe 100 % për kreditë mbi 180 ditë vonesë. Gjithsesi, nuk ka konsensus se si duhet të llogaritur ky axhustim.
- A5 Axhustimi për kreditë e fshira nga bilanci Analistët shpesh axhustojnë kreditë e fshira nga bilanci për t'i vënë ato në një linjë me politikat e standarteve të kontabilitetit. Një standart i përdorur shpesh (që këtu përmendet si shembull) është trajtimi i portofolit në risk > 180 ditë si të fshirë nga bilanci. Në bilanc, të dyja edhe portofoli bruto i kredisë edhe rezerva për humbjen e kredisë zvogëlohen me shumën e kredive të fshira nga bilanci
- A6 Kthimi/anullimi i interesit të përlllogaritur IMF që i njohin të ardhurat nga interesat dhe komisionet nga portofoli i kredisë mbi bazat e përlllogaritjes, e regjistrojnë kur ai fitohet dhe jo kur merret një pagesë në kesh nga huamarrësi. Nëse një kredi nuk shlyhet, atëherë është e drejtë që në një pikë të mos vazhdohet të përlllogaritet më e ardhura nga interesi prej saj, dhe të kthehet/anullohet e ardhura e përlllogaritur më parë. Shumë analistë do të anullojnë gjithë të ardhurat e përlllogaritura mbi kreditë që aktualisht janë me 30 ditë vonesë, përfshirë të ardhurat e përlllogaritura për kreditë që janë fshirë nga bilanci.

Axhustimi për kursin e këmbimit

Kategoria e fundit e axhustimit lidhet me IMF që kanë asete apo detyrime të emëtuara në monedhë të huaj, por kontabilitetin e tij e mban në monedhën vendase. Kur kursi i këmbimit midis dy monedhave ndryshon, vlera e monedhës lokale e aseteve apo detyrimeve ndryshon gjithashtu duke rezultuar në humbje apo fitim. Trajtimi i këtyre humbjeve apo fitimeve normalisht diktohet nga standartet e kontabilitetit lokal. Akoma vazhdojnë debatet se si duhet të regjistrohet humbja apo fitimi nga kursi i këmbimit të monedhës. Disa diskutojnë se kjo humbje apo fitim (1) duhet të regjistrohet në pasqyrën e të ardhurave vetëm kur asetet shiten apo detyrimi likuidohet, ose (2) duhet të konsiderohen si të jashtëzakonshme; pra jo-operacionale. Disa rregullore kërkojnë që (3) ato duhet të regjistrohen në bilanc si shtesë/zvogëlim ndaj llogarive të aseteve apo detyrimeve përkatëse, dhe balancohet me të njëjën rritje/zvogëlim të kapitalit. Nëse pasqyrat financiare të IMF nuk i kanë trajtuar sic duhet fitimet/humbjet nga kursi i këmbimit, analistëve mund t'u duhet të bëjnë një axhustim.